

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama u vë fre pagave të magjistratëve, Kuvendi përcakton me 84 vota formulën e re
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/18/rama-u-ve-fre-pagave-te-magjistrateve-kuvendi-percakton-me-84-vota-formulen-e-re/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:49:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 17 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6fbe8585b2584610f256711012a6a251db5724ed21812b3a27dfafc8ed5e92da
TEKSTI	6e338ff07d83e821fae597f7ef93d526e7b9f4fc7d0237e500b8b438854f0d65
PAMJA	1b78dcf931f54b615c5e6b4f6441f2e85b4280335e23b24b7330532f09c2867b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	311c4ee1601539709791a526c35d3e7b5abb0497fec136819dc1030fe0e49344
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/311c4ee1601539709791a526c35d3e7b5abb0497fec136819dc1030fe0e49344>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rama u vë fre pagave të magistratëve, Kuvendi përcakton me 84 vota formulën e re

Politikë

Publikuar: 18/09/2026

f X



Kuvendi miratoi në orët e para të së premtes, me 84 vota pro, projektligjin e socialistëve për pagat e magistratëve. Kryeministri Edi Rama votoi pro, ndërsa kryetari i PD-së, Sali Berisha, mungoi në momentin e votimit. Por 84 votat zgjidhën vetëm një pjesë të problemit.

Në qendër të konfliktit është formula me të cilën llogaritet paga referuese e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Deri në ndërhyrjen e Gjykatës Kushtetuese, ligji e lidhte këtë pagë me koeficientin 0.36 të pagës së Presidentit të Republikës.

Formula që miratoi mazhoranca e ndryshon koeficientin nga 0.36 në 0.38. Efekti është një rritje e pagës referuese me rreth 8,500 lekë. Pikërisht kjo shifër ka prodhuar kundërshtimin e institucioneve të drejtësisë, sepse përlllogaritja e tyre është shumë më e lartë.

KL Gj vendosi më 26 gusht që, duke filluar nga 1 gushti 2026, paga referuese të llogaritet mbi një bazë prej 222,425 lekësh, nga 156,800 lekë që përdorej më parë. Diferenca vetëm në këtë element është rreth 65,600 lekë. Mbi këtë shumë KL Gj shtoi edhe 14 mijë lekë për nivelin e kualifikimit.

Dy ditë më vonë, më 28 gusht, KLP ndoqi të njëjtën rrugë për prokurorët. Këshilli miratoi me 11 vota pro dhe asnjë kundër pagën referuese prej 222,425 lekësh, plus 14 mijë lekë për nivelin e kualifikimit. Sipas kësaj përlllogaritjeje, baza së bashku me shtesën e kualifikimit arrin në 236,425 lekë.

Formula e socialistëve sjell një rritje të pagës referuese me rreth 8,500 lekë, ndërsa formula e zbatuar nga KL Gj dhe KLP e çon

Me të lexuarat

Kush është

Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të



Doktor Më

duke pyetur bash te Rruga e Kosovareve dhe biznes shit-blejje pronash, deri pas hapjes të video pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares



Historia e gjeneralit kroat të Bosnjes që vrau veten me helm në sallën e gjyqimit në



Haga sapo në me naftë/ Shehu kërkon llogari për gjenocidin serb, Haga rikthen akuzat e ...



vetëm elementin bazë nga 156,800 në 222,425 lekë. Për këtë arsye, në debatet parlamentare kërkesa e institucioneve të drejtësisë është paraqitur si rreth nëntë herë më e lartë se rritja e propozuar nga PS.

Këtu nis edhe konflikti juridik.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 15 të shkurtit 2026, rrëzoi ndryshimet e vitit 2023 për formulën e pagave. Kuvendi duhej të ndërhynte deri më 31 korrik 2026 për të plotësuar boshllëkun e krijuar. Mazhoranca depozitoi propozimin për kalimin nga koeficienti 0.36 në 0.38, por Kuvendi nuk e miratoi formulën brenda këtij afati.

Pas 31 korrikut, KLGJ dhe KLP vepruan vetë.

 Rama u vë fre pagave të magistratëve, Kuvendi përcakton me

Votimi për formulën e re të pagave

Të dy institucionet përcaktuan pagën referuese prej 222,425 lekësh dhe kërkuan që formula të zbatohet nga 1 gushti. KLGJ kërkoi gjithashtu rillogaritjen e diferencave financiare për periudhën nga 1 prilli 2023 deri më 31 korrik 2026.

Ministria e Financave nuk e pranoi këtë interpretim.

Thesari nuk ekzekutoi listëpagesat e hartuara sipas formulës së KLGJ-së dhe KLP-së, ndërsa Ministria argumentoi se përcaktimi i formulës së pagave është kompetencë e Kuvendit. Institucionet e drejtësisë kundërshtuan dhe kërkuan ekzekutimin e listëpagesave sipas përllogaritjes së tyre.

Kështu, një mosmarrëveshje për formulën e pagës u kthye në konflikt për kompetencat.

Mazhoranca thotë se Gjykata Kushtetuese mund të rrëzojë një ligj që bie ndesh me Kushtetutën, por nuk mund të shkruajë formulën financiare në vend të Kuvendit. KLGJ, KLP dhe përfaqësues të tjerë të sistemit të drejtësisë e lidhin përllogaritjen e tyre me efektet e vendimit të Kushtetueses dhe me boshllëkun e krijuar pas 31 korrikut.

Edi Rama e formuloi këtë ndarje edhe politikisht në Kuvend.

Sipas kryeministrit, Gjykata Kushtetuese është arbitri që mund të konstatojë shkeljen dhe të rrëzojë ligjin, por nuk mund të marrë kompetencën e Parlamentit dhe t'i përcaktojë atij formulën që duhet të votojë.

PD mbajti qëndrimin e kundërt. Gazment Bardhi deklaroi se Gjykata Kushtetuese i kishte dhënë Kuvendit katër muaj për ta zgjidhur çështjen dhe e akuzoi mazhorancën se nuk zbatoi vendimin. Demokratët e cilësuan projektligjin e PS-së “puç kushtetues” dhe votuan kundër.

Por përplasia e Ramës nuk është vetëm me opozitën.

Kryeministri vuri në shënjestër edhe shoqatat e gjyqtarëve dhe lëvizjet e koordinuara të institucioneve të drejtësisë. Ai deklaroi se organizimi i tyre rreth çështjes së pagave është shqetësues dhe argumentoi se një pushtet tjetër nuk mund të përcaktojë atë që, sipas tij, mund ta përcaktojë vetëm ligji.

Përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë dhanë një interpretim tjetër gjatë diskutimeve në Komisionin e Ligjeve. Kryetarja e KLP-së, Mirela Bogdani, dhe zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, Ilir Panda, kundërshtuan formulën e mazhorancës dhe iu referuan vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë pikë, Rama ka hapur një kapitull tjetër.

Kryeministri deklaroi se qeveria po punon për një ligj të ri që nuk do të trajtojë vetëm pagën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por të gjithë piramidën e pagave.

Argumenti i tij është se reforma në drejtësi i rriti pagat e magistratëve në një nivel shumë më të lartë se pjesa tjetër e administratës, pa përcaktuar se si do të ribalancohej ky raport në vitet pasuese.

Sipas Ramës, problemi lind nëse çdo rritje e pagave në pjesën tjetër të shtetit sjell automatikisht një rritje tjetër të pagave të magistratëve. Kryeministri kërkon që ligji i ri ta ndërpresë këtë mekanizëm dhe të përcaktojë një raport të ri mes pagave të drejtësisë dhe pjesës tjetër të piramidës shtetërore.

Për këtë projekt, Rama tha se qeveria ka nisur kontakte me Këshillin e Europës dhe me strukturat europiane që trajtojnë eficiencën e sistemeve të drejtësisë.

Kjo do të thotë se formula 0.38 e miratuar me 84 vota nuk përbën domosdoshmërisht pikën përfundimtare të modelit të pagave.

Ajo zgjidh formulën që mazhoranca vendosi të miratojë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por nuk zgjidh mosmarrëveshjen me KLGJ-në dhe KLP-në për shumën e pagës referuese, diferencat e krijuara që nga prilli 2023 dhe kompetencën për të përcaktuar efektet financiare pas skadimit të afatit të 31 korrikut.

Në këtë përplasje janë tashmë tri formula: koeficienti i vjetër 0.36, koeficienti 0.38 që votoi Kuvendi dhe baza prej 222,425 lekësh plus 14 mijë lekë për kualifikimin që përcaktuan KLGJ dhe KLP.

Me votimin e 17 shtatorit, Rama siguroi 84 votat për formulën e mazhorancës. Tani konflikti zhvendoset te zbatimi i saj, detyrimet e prapambetura dhe ligji i ri që kryeministri paralajmëroi për të

gjithë piramidën e pagave. /Pamfleti

TAG:

Kuvendi i shqipërisë

Të ngjashme

Kuvendi miraton emërimin e Ervin Demos si ministër i Brendshëm, merr 83 vota pro. Dy deputetë votojnë kundër

Pagat e magjistratëve/ Bylykbashi prezanton draftin e PS: Rritje sa 2% e pagës së Presidentit

“U përdoqa dhe u fyeva” - Deputetja Luarasi flet për videon e sulmit verbal: 730 komente që flisnin për varje dhe pushkatim

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU](#) [INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.